



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITI OF LIPJAN

KONTRATA

E përpiluar me datën 24.05.2019 ne Lipjan ndërmjet:

- Komunës së Lipjanit të cilën e përfaqëson Drejtori i Drejtorisë së Prokurimit në Lipjan
z. Adem Duriqi në njërin anë (në tekstin e mëtejshëm) Autoriteti Kontraktues dhe

Emri i Kontraktuesit Operatori ekonomik NT "Biti-Com" nga Podujeva të cilin e përfaqëson
Bërat Kaqiu drejtor në vazhdim përdoret (shkurtesa) Kontraktuesi

Titulli i Kontratës: "Furnizimi me fidane dekorative drunore për gjimnazin Ulpiana, furnizimi dhe
mbjellja e luleve në vazot në sheshin Adem Jashari në Lipjan"

Nr referues i kontratës 613 019 060 136

Neni 1 Lënda

Lënda e kontratës është: Furnizimi me fidane dekorative drunore (lloji Katalpa me gjatësi min 3m ,
lejla me gjatësi min 2m dhe lejlan shatir min 1.5m) për gjimnazin Ulpiana, furnizimi dhe mbjellja e luleve
në vazot në sheshin Adem Jashari në Lipjan furnizimi me humus 8 thasë prej 25 litrave për përgatitjen e
sipërfaqeve për mbjellje të luleve dhe mirëmbajtja e luleve nëpër vazo për 4 muaj, (ujitje minimum 2
herë në javë e sipas nevojës edhe më tepër, mihje largimi i barit sipas nevojës). Llojet e luleve që do të
mbillen krizantena grandiflora 56 copë dhe Calluna garden 224 copë.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me vënien e nënshkrimit nga të dy palët ,gjegjësisht me 24.05.2019
dhe përfundon 4 muaj pas fillimit të ekzekutimit

1.3 Afati kohor i performancës nuk mund të jetë më shumë se për mbjellje të luleve 5 ditë nga
nënshkrimi i kontratës ndërsa mirëmbajtja për 4 muaj.

1.4 Vendi i kryerjes së furnizimeve janë Sheshi Adem Jashari dhe depq (oborri i gjimnazit Ulpiana)

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë LPP-04/L-042. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të
kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata Komunale Lipjan.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi përgjithshëm i kontratës shprehur në shifra është 1,645.00 € me fjalë njëmijë e gjashtëqind e katërdhjetë e pesë /euro/ e zero /cent/

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Pagesa për pozicionet prej 1-7 do të paguhet pas pranimit të raportit të menagjerit për përfundimi të furnizimit dhe mbjelljes së luleve dhe furnizimit të drujve dekorativ ndërsa pozicioni 8 do të paguhet në fund të çdo muaji për sa do të zgjasë kjo kontratë

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës nëse fatura e ka të bashkangjitur raportin e menaxherit të kontratës së shërbimet janë kryer me cilësi dhe në afat sipas planit dinamik të paraparë në kontratë. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 4 muaj pas pranimit të furnizimeve së drunjte dekorativ do të zhvillohen dhe nëse vërehet se ndonjë apo disa drunjte dekorativ nuk zhvillohen kontraktuesi është i obliguar t'i zëvendësojë me drunjte të cilët do të zhvillohen, kjo vlenë edhe për lulet

Kontraktuesi do të garantojë se asnjë nga furnizimet nuk kanë asnjë defekt dhe kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Kontraktuesi me rastin e nënshkrimit të kontratës është i obliguar që të bëjë garancionin në formë të një deklarate me shkrim për 4 muaj.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,5% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë fidanet e luleve apo drujve dekorativ që janë përgatitur për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse bimët kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Menaxher të kontratës janë Salihe Marevci dhe Rafete Retkoceri.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumë që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më

shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën komunale në Lipjan në pajtim me ligjin e Kosovës.


Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqip në 4 origjinale, 3 origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Operatorin Ekonomik

Emri:	Adem Duriqi	Emri:	Berat Kaqiu
Pozita:	Drejtor i prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	24.05.2019	Data:	24.05.2019
Vula:		Vula:	

Seksioni II. Formulari i PËRSHKRIMIT TË ÇMIMIT
Furnizimi i SHML gjimnzi Ulpiana me drunjë dekorativ

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi /njësi	Shuma
1	Furnizimi me bimë drunore dekorative Katalba gjatësia min 3m	copë	4	15.00	60.00
2	Furnizimi me bimë drunore dekorative Leljan gjatësia min 2m	copë	35	12.00	420.00
3	Furnizimi me bimë drunore dekorative Leljan shatir gjatësia min 1.5m	copë	25	12.00	300.00
Furnizimi dhe mbjellja e luleve në vazot Sheshi Adem Jashari					
4	Pastrimi i terrenit dhe përgatitja e vendit për mjelljen e luleve	m2	450	0.50	225.00
5	Furnizimi dhe mbjellja e luleve "Krizantena grande flore	copë	56	1.00	56.00
6	Furnizimi dhe mbjellja e luleve "Calluna garden	copë	224	1.00	224.00
7	Furnizimi me substrat dhe shtrirja nëpër vazo për lulet e mbjella,thas 25 kg	copë	8	20.00	160.00
8	Mirëmbajtja e luleve (ujitja , mihja, heqja e barit) për periudhen 4 mujore, keto aktivitete duhet te kryhen min. 4 here brenda muajit, sipas nevojës ne terren edhe me shpeshvarsisht nga kushtet atmosferike , çmimi jepet komplet per aktivitetet (mihje ,ujitje, heqje bari)	muaj	4	50.00	200.00
Shuma e përgjithshme					1,645.00€